



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

V E N D I M

Nr. 105, Datë 28 / 09 / 2017

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 03, datë 16.01.2017, të bërë nga R.O, kundër DAR Tiranë Qark dhe ZA Kavajë në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike” dhe “gjendjes civile”¹.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna², në shkresat, protokolluar tek Komisioneri në datat 31.01.2017 dhe 06.02.2017, subjekti ankues deklaroi se ka qenë në marrëdhënie pune me ZA Kavajë nga data 02.09.2013 deri në datë 15.08.2014, në pozicionin si mësuese në shkollën Helmës. Me Urdhrin nr.27, datë 23.06.2014, ZA Kavajë i ka ndërprerë marrëdhëniet e punës pa shkak të justifikuar, fakt i cili është konfirmuar dhe nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr.473, datë 16.04.2015, marrë formë të prerë më datë 04.07.2015. R.O ka aplikuar, konkurruar dhe ka ndjekur të gjitha procedurat³ për tu punësuar sërish në institucionet arsimore publike por nuk është punësuar për shkak të bindjes politike. R.O e licencuar në profilin Histori-Gjeografi-Edukatë, pretendon se gjatë kohës që priste për tu punësuar si konkurrencte e renditur e

¹ Referuar dokumentit: Certifikatë Familjare, nr. serie: 010802746, datë 10.01.2017 të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Kavajë, rezultoi se R.O është bashkëshortja e shtetasit R.O, Kryetar i subjektit politik “Partia Demokratike e Shqipërisë” në vitet 2012-2014 dhe aktualisht anëtar i Këshillit Bashkiak Kavajë.

² Me shkresën nr.13/1, datë 24.01.2017 i është kërkuar subjektit ankues, dokumentacion dhe shpjegime shtesë.

³ Ka konkurruar në portalin Mësues për Shqipërinë, në datat: 06.12.2014, 19.12.2015 dhe 21.01.2017. R.O zotëron licencën nr. 1411000852, datë 26.10.2015.

treta, janë punësuar dy persona pa licencë: I.C i profilit Histori-Gjeografi-(Qytetari), pa licencë në muajin Mars 2015 i punësuar në fshatin Stërbeg dhe në datë 23.01.2017 në fshatin Kryevidh dhe V.Rr e profilit Histori-Gjeografi-Qytetari, pa licencë në muajin Tetor 2015 e punësuar në fshatin Mushnikë. Të dy të punësuarve vazhdojnë dhe i rinovohen kontratat e punës.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe kthimin në punë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi për shkak të bindjes politike dhe gjendjes civile është një formë diskriminimi e parashikuar nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3/4 dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 33/4 të ligjit nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankesa e paraqitur nga ankuesja, R.O, është e vlefshme nga pikëpamja formale pasi nuk ekziston asnjë nga rastet përjashtuese të parashikuara në këtë nen, që do ta bënte këtë ankesë të papranueshme. Si pasojë ankesa iu nënshtrua shqyrtimit të plotë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën Nr. 13/1, datë 24.01.2017 është kërkuar nga subjekti ankues plotësim dokumentacioni dhe kërkesë për informacion.

- Me shkresën nr. 13/4, datë 06.02.2017 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjektit, Drejtoria Arsimore Rajonale, Tiranë Qark dhe Zyra Arsimore Kavajë, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga R.O.

Me shkresën nr. 241, datë 15.02.2017, Drejtoria Arsimore Rajonale, Tiranë Qark, informon Komisionerin se bazuar në legjislacionin në fuqi Zyra Arsimore Kavajë është institucion më vete dhe përgjigjet për emërimet, lëvizjet paralele dhe largimet nga puna për punonjësit nën juridiksionin e saj.

Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhrin nr. 42, datë 17.03.2017 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Për kryerjen e inspektimit pranë Zyrës Arsimore Kavajë”, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë Zyrës Arsimore Kavajë, më datë 28.03.2017, për të kryer verifikimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Gjatë inspektimit pranë Zyrës Arsimore Kavajë, inspektorët e KMD-s, morën takim me S.P, me detyrë Përgjegjëse e Zyrës Arsimore dhe T.D me detyrë Specialist i Burimeve Njerëzore.

Gjatë inspektimit T.D informoi se: *“Referuar rezultateve të testimit sipas portalit “Mësues për Shqipërinë”, nr. 34. Prot, datë 29.01.2016 është punësuar vetëm F.Rr e renditur në vendin e dytë në lëndën Histori-Gjeografi, pasi personi i renditur në vendin e parë N.D, refuzoi të emërohej në Kavajë pasi ishte banor i qytetit të Rrogozhinës dhe L.H është punësuar si mësues duke plotësuar orët dhe në lëndën e ekonomisë, me ngarkesë të plotë mësimore. Në vitin 2016 nga rezultatet e portalit janë punësuar F.Rr e renditur në vend të dytë dhe D.V e renditur në vend të tretë dhe nuk ka të punësuar të tjerë nga kjo listë. Referuar rezultateve të testimit “Mësues për Shqipërinë”, nr.89/1 datë 21.02.2017 nuk ka të punësuar asnjë mësues, për arsye se pas shpalljes së listës nuk ka patur vende të lira për mësues”.*

Në lidhje me emërimin e I.C, T.D informoi se: *“Në vitin 2015 është bërë emërimi i përkohshëm deri në rikthimin në punë të një mësuesi me raport mjekësor, ndërsa në datë 23.01.2017 është bërë emërimi i I.C si mësues i lëndës së Edukimit Fizik në dy shkolla. I.C është mësues i palicensuar i profilit Histori-Gjeografi. Mësuesja V.Rr e profilit Histori-Gjeografi nuk është e licencuar dhe ka patur kontratë të përkohshme deri në përfundim të procedurave të konkurrimit të portalit, i cili nuk ka filluar të aplikohet akoma”.*

Gjatë inspektimit S.P, deklaroi se në Zyrën Arsimore Kavajë nga data 01.09.2016 deri më 28.03.2017 nuk janë lidhur kontrata për asnjë mësues të lëndës Histori-Gjeografi.

Nga verifikimi i kryer në tabelën⁴ e rezultateve të aplikantëve në testimin për portalin “Mësues për Shqipërinë” 2016 të ZA Kavajë, rezulton se renditja për lëndën Histori-Gjeografi, është si më poshtë: N.D, F.RR, D.V, J.M, V.L, A.SH, L.H dhe më poshtë me pikë të barabarta nga 41 janë, M.P dhe R.O.

⁴ Shkresa nr. 34 prot, datë 29.01.2016

Nga verifikimi i kryer në tabelën⁵ e rezultateve të aplikantëve në testimin për portalin “Mësues për Shqipërinë” 2017 të ZA Kavajë, rezulton se renditja për lëndën Histori-Gjeografi, është si më poshtë: I.A, F.RR, M.GJ, S.V, A.K, S.Q, A.I, A.XH, B.D dhe më poshtë me pikë të barabarta nga 41 janë, B.H dhe R.O.

Nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me marrëdhëniet e punës të I.C, rezulton se: *“Me Urdhrin nr.187, datë 01.10.2015 nga ana e ZA Kavajë është bërë miratimi i Vendimit nr.36, datë 01.10.2015 të drejtorisë së shkollës “Stërbeg” për emërimin e përkohshëm të I.C si mësues zëvendësues i profilit Histori-Gjeografi në vend të mësueses me raport mjekësor. Me Vendimin nr.2, datë 23.01.2017 të shkollës 9-vjeçare “Stërbeg” është bërë emërimi i I.C si mësues për lëndët e profilit Edukim Fizik dhe djathtësi, në shkollën 9-vjeçare “Stërbeg” dhe “Kryevidh” deri në përfundim të vitit shkollor 2016-2017”.*

Nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me marrëdhëniet e punës të V.Rr, rezulton se: *“Me Vendimin nr.9, datë 26.09.2016 të drejtorisë së shkollës 9-vjeçare “Okshtun” është bërë emërimi i përkohshëm i mësueses V.Rr si mësuese për lëndët e profilit shoqëror në shkollën vartëse “Mushnikë” deri në përfundim të procedurave të konkurrimit të portalit “Mësues për Shqipërinë” (31 Dhjetor 2016). Me Vendimin nr.12, datë 06.01.2017 të drejtorisë së shkollës 9-vjeçare “Okshtun” është bërë përsëri emërimi i përkohshëm i mësueses V.Rr si mësuese për lëndët e profilit shoqëror në shkollën vartëse “Mushnikë” deri në përfundim të procedurave të konkurrimit të portalit “Mësues për Shqipërinë” (28 Shkurt 2017). Me Vendimin nr.12, datë 01.03.2017 të drejtorisë së shkollës 9-vjeçare “Okshtun” është bërë përsëri emërimi i përkohshëm i mësueses V.Rr si mësuese për lëndët e profilit shoqëror në shkollën vartëse “Mushnikë” deri në përfundim të vitit shkollor 2016-2017 (Qershor 2017)”.*

- Me shkresën nr. 654, datë 21.06.2017 i është kërkuar informacion shkollës 9-vjeçare Okshtun në lidhje me procedurën e përzgjedhjes dhe emërimit të mësueses V.Rr në shkollën Okshtun.

Me shkresën datë 05.07.2017, Drejtori i shkollës 9-vjeçare Okshtun informon se: *“Mësuesja V.Rr është emëruar si mësuese me kontratë të nënshkruar nga drejtori i shkollës dhe punëmarrëses V.Rr me profilin Edukim Qytetar. Gjatë vitit shkollor 2016-2017 ngarkesa mësimore ka qenë për lëndët: Histori, Gjeografi, Qytetari, Edukatë Shoqërore, Gjuhë Shqipe, Edukim Muzikor, Vizatim, Aftësim Teknologjik dhe Kurrikul me zgjedhje në shkollën 9-vjeçare Mushnikë, vartëse e shkollës 9-vjeçare Okshtun”.*

III. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

⁵ Shkresa nr. 89/1 prot, datë 21.02.2017

A. Lidhur me pretendimin e ankueses se është trajtuar ndryshe nga ZA Kavajë, përmes mos marrjes në punë.

Ankuesja referuar dokumentacionit të dërguar pranë Komisionerit ka vërtetuar se ka konkurruar në portalin Mësues për Shqipërinë, në datat: 06.12.2014, 19.12.2015 dhe 21.01.2017 dhe që nga ajo periudhë në mënyrë të përsëritur i është drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit⁶ dhe Zyrës Arsimore Kavajë⁷ në të cilën ka kërkuar që të punësohet si mësuese, por të gjitha kërkesat e bëra pavarësisht dhe interesimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, nuk kanë marrë përgjigje nga ana e ZA Kavajë.

Në nenin 57/4 të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet se: *“Mësuesi i arsimit fillor dhe i arsimit të mesëm ka të drejtën e ushtrimit të profesionit të mësuesit pasi të ketë kryer me sukses praktikën profesionale dhe të ketë kaluar provimin e shtetit, siç parashikohet në ligjin nr.10171/2009 “Për profesionet e rregulluara në RSH” të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij”.*

Në Kreun 4, pika 2 e Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar” përcaktohet se: *“Kandidati me numrin më të madh të pikëve ftohet nga komisioni dhe zgjedh një nga vendet e lira të punës (me ngarkesë të plotë apo të pjesshme, të përkohshme apo të përhershme), sipas preferencës së tij, në prani të drejtorëve të institucioneve arsimore ku janë vendet e lira të punës”.*

Referuar Udhëzimit nr. 44, datë 16.10.2014 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e MASH nr. 21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore- edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar” përcaktohet se: *“Për arsimin e mesëm të ulët (klasat VI-IX) profili i kërkuar për mësuesit në lëndën: Histori, Gjeografi është: Histori-Gjeografi dhe për lëndën Edukim Fizik është: Edukim Fizik ndërsa profili i përafërt është: E mesme e fizkulturës e profilizuar për mësuesi, shkalla I e kualifikimit”.*

Referuar legjislacionit të sipërcituar konkludohet se një individ për tu punësuar si mësues në arsimin e mesëm të ulët në lëndët Histori, Gjeografi dhe Edukim Fizik duhet të jetë i pajisur me diplomë universitare të arsimit të sipërcituar dhe të jenë të pajisur me licencë për ushtrimin e profesionit të mësuesit në profilin përkatës.

- Referuar arsimimit të R.O vërtetohet se ajo plotëson kriterin e arsimit të lartë po ashtu zotëron dhe licencën⁸ për ushtrimin e profesionit në profilin Histori-Gjeografi-Edukatë.
- Referuar dokumentacionit të shqyrtuar të vënë në dispozicion nga ZA Kavajë, rezulton se mësuesit, I.C dhe V.Rr nuk janë të licencuar për të ushtruar profesionin e mësuesit në

⁶ Shkresat nr.12249, datë 07.12.2017, nr.2020, datë 29.02.2016, nr.10215, datë 04.11.2016

⁷ Shkresat datë 05.04.2016 dhe 23.11.2016,

⁸ Numri i licencës: 1411000852, datë 26.10.2015

lëndët për të cilat janë emëruar, pasi I.C nuk zotëron licencën për të ushtruar profesionin e mësuesit në lëndën e Histori-Gjeografi dhe shkollimin për të ushtruar profesionin e mësuesit në lëndën e Edukimit Fizik, po ashtu dhe V.Rr, e cila është e palicencuar.

Në vlerësim të dokumenteve të administruara mbi procedurat e përdorura nga ZA Kavajë për emërimet e punonjësve arsimorë, Komisioneri konstaton se janë në kundërshtim me legjislacionin e arsimit dhe e kanë vendosur ankuesen në pozita të pafavorshme në raport me mësuesit e emëruar (që nuk plotësojnë kriteret ligjore) edhe pse ajo i plotësonte kriteret e kërkuara nga ligji.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se praktika e vendosur nga ZA Kavajë me emërimet e përkohshme të mësuesve, duke mos zhvilluar procedurat e vendosura në ligj ka vendosur R.O në pozita të pafavorshme, duke mos i dhënë mundësinë për tu punësuar si mësuese sipas procedurave ligjore.

B. Lidhur me shkakun e pretenduar nga ankuesja (bindja politike dhe gjendja civile) si shkak të sjelljes diskriminuese ndaj saj.

Pretendimi i ankueses se shkak për diskriminimin e saj është bindja politike dhe lidhja familjare me R.O, Kryetar i subjektit politik “Partia Demokratike e Shqipërisë” në vitet 2012-2014 dhe aktualisht anëtar i Këshillit Bashkiak Kavajë që është bashkëshorti i R.O, përbën një shkak që gëzon mbrojtje sipas nenit 1 të ligjit.

Njohja me bindjet politike të subjektit ankues vërtetohet duke iu referuar dokumentacionit⁹ të dorëzuar në të cilin provohet se R.O është anëtare e subjektit politik “Partia Demokratike e Shqipërisë”.

Referuar dokumentit: Certifikatë Familjare, nr. serie: 010802746, datë 10.01.2017 të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Kavajë, rezulton se shtetasja R.O është bashkëshortja e R.O.

C. A ka qenë qëndrimi diferencues ndaj ankueses, i arsyeshëm dhe objektiv?

Nga dokumentet e administruara gjatë trajtimit të ankesës, dhe shpjegimet e dhëna nga ZA Kavajë, lidhur me mos shqyrtimin e kërkesave për punësim të ankueses, drejtuesit e ZA Kavajë janë kontradiktorë dhe jo koherent në qëndrimet e tyre. Gjatë inspektimit të zhvilluar në datë 28.03.2017, drejtuesit e ZA Kavajë kanë deklaruar¹⁰ se: **“Gjatë periudhës kur ka kërkuar që të punësohet R.O nuk ka pasur punësime si mësues në lëndën Histori-Gjeografi, ndërkohë që vet ato vunë në dispozicion të Komisionerit informacion dhe kopje të kontratave të lidhura me I.C dhe V.Rr për periudhën e vitit 2016-2017”.**

⁹ Kartë anëtarësimi, datë 14.05.2014.

¹⁰ Referuar procesverbalit të inspektimit, datë 28.03.2017.

Sa më sipër, drejtuesit e ZA Kavajë nuk dhanë asnjë shpjegim përse janë punësuar me kontratë të përkohshme mësues të palicensuar dhe në shkelje të procedurave ligjore dhe nuk i janë propozuar këto pozicione pune mësuesve sipas renditjes së portalit “Mësues për Shqipërinë”.

Bazuar në Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”, Kreu 4, “Procedura e zgjedhjes së vendit të punës dhe emërimi i mësuesit”, pika 9, “Për vendet e lira me ngarkesë mësimore të pjesshme apo të përkohshme, lidhet kontratë e përkohshme pune ndërmjet drejtuesit të institucionit arsimor dhe kandidatit. Kandidati i punësuar sipas kësaj pike, nuk e humbet të drejtën për t’u njoftuar për të zgjedhur, sipas këtij kreu, si dhe ka të drejtën e ndërprerjes së njëanshme të kontratës përpara afatit”, specifikohet se është në tagrin e drejtuesit të institucionit të arsimit parauniversitar të bëjë emërimet në përputhje me parashikimet ligjore të përcaktuara në këtë udhëzim. Komisioneri vlerëson se drejtuesit e institucioneve arsimore janë në shkelje të emërimeve të mësipërme si dhe ZA Kavajë ka qenë në dijeni të këtyre emërimeve, të cilat rezultojnë të paligjshme, pasi nuk janë respektuar procedurat e emërimit dhe ka shkelje në kualifikimin e mësuesve. Gjithashtu ZA Kavajë edhe pasi ka marrë dijeni për parregullsitë në emërim nuk ka marrë asnjë masë për të vendosur në ligjshmëri procedurën e emërimit në shkollat e sipërcituara.

Në Kreun 5/1 të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”, përcaktohet se: “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve të kandidatëve për mësues, për të tri fazat, drejtuesi i njësisë arsimore vendore krijon Komisionin e Vlerësimit”, ndërsa në pikën 5/g të këtij Kreu përcaktohet se: Komisioni është përgjegjës për: Monitorimin e punësimeve sipas renditjes së përgjithshme të kandidatëve dhe raportimin në MAS, çdo tre muaj”. Në referim të dispozitës së cituar, nga ana e drejtuesve të ZA Kavajë, nuk u vendos në dispozicion të Komisionerit asnjë dokumentacion që të vërtetonte se ishte respektuar kjo procedurë për rastet e emërimit për punonjësit mësimorë, I.C dhe V.Rr.

Në nenin 12/1/b) të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve”.

Në analizë të shkakut të pretenduar nga ankuesja, sjellim në vëmendje Nenin 82, pika 2, të Ligjit Nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative, ku parashikohet: **“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”**. Zyra Arsimore Kavajë nuk vuri në dispozicion

të Komisionerit prova dhe të jepte argumente të arsyeshme dhe të ligjshme për të cilin këto pozicione pune nuk janë plotësuar nga mësues të renditur sipas portalit si dhe të vërtetonte se marrja në punë e punonjësve mësimorë të palicensuar, I.C dhe V.Rr përbënte një procedurë të rregullt ligjore për të ndjekur një qëllim të ligjshëm.

Komisioneri në analizë të dokumenteve të shqyrtuara vlerëson se procedurat e emërimit të zhvilluara pas datës 26.10.2015¹¹ e kanë ekspozuar R.O (por dhe personat e tjerë të renditur më lart, sipas rezultateve të testimit për portalin “Mësues për Shqipërinë”) ndaj një trajtimi të padrejtë dhe diskriminues nga ana e drejtuesve të Zyrës Arsimore Kavajë, trajtim i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë, me bindjen politike dhe gjendjen civile të ankueses.

Komisioneri, mendon se në këtë çështje duhet vlerësuar dhe parimi për interesin më të lartë të fëmijëve dhe të drejtën e tyre për një arsimim cilësor dhe mendon se punësimi i mësuesve të palicensuar i cënon ato në këtë të drejtë. Prandaj, ZA Kavajë dhe drejtoritë e shkollave 9-vjeçare “Stërbeg” dhe “Okshtun”, duhet të veprojnë në ligjshmëri, duke zbatuar kërkesat e Urdhrit nr. 363, datë 16.09.2014 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për përcaktimin e nivelit arsimor të mësuesit në institucionet publike të arsimit parauniversitar” dhe Udhëzimit nr. 44, datë 16.10.2014 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e MASH nr. 21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/a), b), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të shtetasës R.O, për shkak të bindjes politike dhe gjendjes civile të saj, nga ana e Zyrës Arsimore Kavajë.
2. Në referim të pikës 1, dhe bazuar në nenin 33/10 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri urdhëron që Zyra Arsimore Kavajë të realizojë procedurat për emërimin e mësuesve sipas portalit “Mësues për Shqipërinë” në shkollat “Stërbeg” për lëndën Edukim Fizik dhe “Okshtun” për lëndët e profilit shoqëror.

¹¹ R.O është licencuar në profilin Histori-Gjeografi-Edukatë në datë 26.10.2015.

3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Zyra Arsimore Kavajë, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI